



VENDIM

Nr. 70 Datë 13.05.2015

PËR

LICENSIMIN E SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ”KACNI”, ME FUQI TOTALE 3.87 MW.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pikat 1, gërma “a”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KISI-BIO-ENERGJI” SH.P.K. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike, te kësaj shoqërie, nga hec ”Kacni”, me fuqi totale 3.87 MW.

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “KISI-BIO-ENERGJI” SH.P.K., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i percaktuar ne: nenin 9, pikat 1 (formatin e aplikimit,); Nenin 9, pikat 2 (dokumentacionin juridik, administrativ dhe

pronësor); Nenin 9, pikat 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar ne menyre korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licenses te percaktuara ne: Nenin 9, pika 4.1.1 (Te dhena specifike per HEC); Neni 9, pika 4.1.2 (Te dhena per bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); Neni 9, pika 4.1.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik); Neni 9, pika 4.1.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione te tjera), eshte plotësuar teresisht.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “KISI-BIO-ENERGJI” SH.P.K., në aktivitetin e prodhimit të energjise elektrike nga hec ”Kacni”, me fuqi totale 3.87 MW, per nje afat 30 vjecar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI